

## NDIKIMI I INDUSTRISE TEKSTILE NE MJEDIS

Emetimi në mjedis i ndotësve të ndryshëm, të shkaktuar nga aktivitetit i industrisë tekstile, shkaktohet paraprakisht nga substancat që ndodhen në lëndën e parë ( papastërti dhe materiale që shoqërojnë fibrat natyrale, agjentë paratrajtues, lubrifikantë të tjerrjes, agjentë kollaritës, etj). Të gjithë këto substanca, zakonisht, largohen nga ~~fibrat në procesin~~ e përpunimit përgatitor para ngjyritit dhe përmbarimit. Largimi i substancave ndihmëse gjatë paratrajtimit në të njomë krijon jo vetëm ndotje organike me shkallë të ulët biodegradimi (vajrat mineralë), por shkakton edhe emetim të substancave me rrezikshmëri të lartë, si hidrokarbure poliaromatikë, alkil fenol etoksilate dhe biocide. Nevoja kimike për oksigjen (NKO) e ujërave të ndotura nga këto procese paratrajtuese është 40 - 80 g/kg fibër. Në rastin kur materialet përpunohen në rrugë të thatë (stabilizim termik) shkaktohet ndotje e konsiderueshme në ajër. Ujërat e larjes, që shkarkohen nga fabrikat e çkollaritjes të materialeve celulozike, përmbajnë afro 70% të ngarkesës së përgjithshme të ndotësve që ndodhen në shkarkimet ujore. Nga ana tjetër përdorimi i agjentëve zbardhës me bazë klori çojnë në formimin e komponimeve klor-organike të absorbueshme, sasia e të cilëve në ujëra është në vlerat 90-100 mgCl/l. Në rastin kur procesi i zbardhimit kryhet me peroksid hidrogjeni, H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>, ndotjet shkaktohen nga përdorimi i agjentëve kompleks-formues (stabilizues). Në rast se nuk aplikohet procesi i rikuperimit të NaOH pas procesit të mermerizimit, në sistemin e trajtimit të shkarkime derdhen ujëra që përmbajnë 40-50 g NaOH/l.

Industria e tekstitit ka qenë dënuar si një ndër kundravajtësit më të këqinj në botë për sa i përket ndotjes, sepse ajo kërkon një sasi të madhe të dy komponentëve: kimikate dhe ujë. Rreth 2.000 kimikate të ndryshme përdoren në industrinë e tekstitit, që nga ngjyrat e deri në agjentët transferues. Ndërsa uji, burimet e të cilit po pakësohen gjithnjë e më shumë, nevojitet në çdo hap të procesit industrial, si për të përcjellë kimikatet e përdorura, ashtu edhe për shpëlarjen e tyre. Uji ngopet me shtesa kimike dhe nxirret në formën e shkarkimeve, të cilat nga ana e tyre e ndotin mjedisin me nxehtësinë e tyre, me pH e rritur dhe me kimikatet që përmbajnë: ngjyronjës, shkumëzues, detergjentë, zbardhues optikë

dhe shumë kimikate të tjera. Pëlhurat e prodhuara tradicionalisht përmbajnë mbetjet e kimikateve të përdorura gjatë prodhimit të tyre: substanca kimike që avullojnë në ajrin që thithim ose absorbohen nëpërmjet lëkurës sonë. Disa nga kimikatet janë kancerogjene, ose mund të shkaktojnë dëme tek fëmijët, ndërsa të tjerë mund të shkaktojnë reaksione alergjike në disa njerëz. Problemet më të rëndësishme mjedisore të lidhura me përpunimin e njomë të tekstilit janë: përpunimi kimik intensiv në të njomë - pastrimi, zbardhja, ngjyrosja, printimi etj., metalet e rënda që gjenden në bojëra, në lidhës, etj., mbetjet kimike të bojërave në ujë për shkak të fiksimit të dobët të ngjyrave , PVC dhe ftalate të përdorur në pastën e printimit, aldehidi formik që gjendet në agjentët dispergues, në pastën printuese dhe fiksuesit e ngjyrave. Eko-tekstilet janë çdo produkt tekstil që është prodhuar në mënyrë miqësore me mjedisin. Ka një larmi të tekstileve të konsideruar të tillë, së pari për aftësinë e produktit për t'u ripërtëritur. Faktori i dytë është gjurma ekologjike e burimit - sa tokë (zakonisht matet në hektarë) duhet për të rritur e mbajtur një nga individët (bimët ose kafshët). Gjëja e tretë për t'u marrë parasysh në përcaktimin e një eko-produkti të veçantë është se sa kimikate kërkon ai për ta bërë gati për treg. Tekstilet që bëjnë pjesë në këtë grup janë pambuku organik, mëndafshi organik, leshi organik, mëndafshi i sojës, kërpi, torfa, bambuja, etj.

Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë

Tiranë, Mars 2012